

# RRËFENJAT URBANE BRENDA SHPREHJEVE FRAZELOGJIKE

M.Sc Migena **ARLLATI**

Akademia “Rrënjët Tona”

## PËRMBLEDHJE

Bashkëjetesa në të njëjtën shoqëri shfaq veçoritë dhe karakteristikat gjuhësore të individëve brenda mikrosistemit, si dhe karakteristikat e të gjithë grupit shoqëror brenda akrosistemit. Gjuha dhe komunikimi shpesh bëhen bartës të këtyre tipareve. Në shumë raste vërejmë se ngjarje të së shkuarës kanë mbetur në kujtesën kolektive si të ashtuquajturat “legjenda urbane”. Ato marrin jetë dhe forcohen duke u pasqyruar në shprehjet frazeologjike, por me kalimin e kohës humbin lidhjen me ngjarjen fillestare, pra me shkakun e vërtetë që i ka krijuar. Një sërë krijimesh të tilla idiomatiko-frazeologjike vijnë si rrjedhojë e ngjarjeve historike apo shoqërore, rrethanave politike apo zhvillimeve të kohës, të cilat sipas rastit apo veçorisë “gdhendën” në legjendat urbane, në rrëfimet kolektive etj. Historiko-etimologjike. Kërkimi mund të na çojë te burimi apo rrethanat e krijimit të tyre. Por përveç faktorëve gjuhësorë, këtu duhen trajtuar edhe ata jashtëgjuhësor, si dhe të dhëna të tjera si diakronia, etimologjia etj. Është pak e vështirë të përcaktosh konkretisht vendlindjen e frazeologjisë, apo të flitet për të drejtën e autorit. Këto shprehje janë bërë pjesë e makrosistemit, ndaj për të drejtën e autorësisë së tyre mund të pretendojnë njëkohësisht disa grupe banorësh, ose disa rajone apo njësi administrative. Disa nga këto njësi frazeologjike janë motivuese edhe në gjendjen aktuale (në sinkron), ndërsa të tjerat janë të pamotivuara, por edhe kjo pjesë mund të motivohet historikisht (në diakroni). Qëllimi i këtij punimi është të tregojë përfshirjen dhe ngjeshjen e ngjarjeve që kanë ndodhur në jetën reale në frazeologji. Këto ngjarje, e ashtuquajtura “rrëfim urban”, shfaqen në shprehje frazeologjike me emra të veçantë, emra vendesh apo zonash dhe të dhëna të tjera që dëshmojnë disi për ngjarjen e dikurshme. Metoda e përdorur është së pari, grumbullimi i materies nga përdorimi i përditshëm në masën e njerëzve; së dyti, përzgjedhja e atyre shprehjeve që mendohet se mbartin brenda vetes një histori a rrëfim; së treti, analiza përmes diskutimit, lidhjes së fijeve logjike dhe hamendësimeve; së katërti, përfundimet.

***Fjalë kyçe:** legjendat urbane, shprehja e frazave, motivimi, kujtesa kolektive.*

## ABSTRACT

Coexistence in the same society displays the linguistic features and characteristics of individuals within the microsystem, as well as the characteristics of the whole social group within the macrosystem. Language and communication often become carriers of these traits. In many cases we notice that events of the past have remained in the collective memory as the so-called "urban legends". They come to life and are strengthened by being reflected in phraseological expressions, but over time they lose the connection with the initial event, ie with the real cause that created them. A series of such idiomatic-phraseological creations come as a result of historical or social events, political circumstances or developments of the time, which depending on the case or peculiarity, are "engraved" in urban legends, collective narratives, etc. Historical-etymological research can lead us to the source or circumstances of their creation. But in addition to linguistic factors, extralinguistic ones should also be treated here, as well as other data such as diachrony, etymology, etc. It is a bit difficult to concretely define the birthplace of phraseology, or to talk about copyright. These expressions have become part of the macrosystem, so for the right of their authorship can claim simultaneously several groups of inhabitants, or several regions or administrative units. Some of these phraseological units are motivating even in the present state (in synchrony) while the rest are unmotivated but even this part can be motivated historically (in diachrony). The purpose of this paper is to show the inclusion and compression of events that occurred in real life in phraseology. These

events, the so-called "urban narrative", appear in phraseological expressions with separate names, names of places or areas, and other data that testify somewhat about the former event. The method used is first, the accumulation of matter from everyday use to the mass of people; second, the selection of those expressions that are thought to carry within themselves a story or narrative; third, analysis through discussion, connecting logical threads and conjecture; fourth, conclusions.

**Key words:** *urban legends, phrase expression, motivation, collective memory.*

## **RRËFENJAT URBANE BRENDA SHPREHJEVE FRAZELOGJIKE**

Gjuha dhe komunikimi shpesh herë bëhen bartës të këtyre veçorive. Në raste të shumta vërejmë se ngjarje të kohëve të shkuara, kanë mbetur në kujtesën kolektive si të ashtuquajtura "legjenda urbane". Ato marrin jetë dhe fuqizohen duke u reflektuar kohë më vonë në shprehje frazeologjike, por sa më shumë me kalimin e faktorit kohë e humbin lidhjen me ngjarjen fillestare, pra me shkakun e vërtetë që i ka krijuar. Subjekti i ngjarjes reale mjegullohet dhe tretet në mister sa më shumë kohë të kalojë, ndërsa shprehja frazeologjike, tashmë si togfjalësh i ngurtësuar, vazhdon të jetojë, pavarësisht se burimi nga ka erdhur mund të jetë harruar ose larguar nga kujtesa. Këto rrëfime i përkasin kujtesës kolektive. Vetëm si të tilla ato mund të fitojnë peshën e një shprehjeje të thuktë, apo një togfjalëshi që me kalimin e kohës është tkurrur. Ai tashmë jeton i pavarur nga ngjarja a subjekti prej të cilit mori jetë vite, dekada a shekuj më parë. Një sërë krijimesh të tilla idiomatike - frazeologjike vijnë si rrjedhojë e ngjarjeve historike ose sociale, rrethanave politike ose zhvillimeve të kohës, të cilat varësisht nga rasti a veçantia që kanë "gdhenden" në legjenda urbane, rrëfenja kolektive etj. Gjurmimi historiko - etimologjik jo gjithmonë mund të na dërgojë tek burimi a rrethanat e krijimit të tyre. Por përveç faktorëve gjuhësorë, këtu duhen trajtuar edhe ata jashtëgjuhësorë, si dhe të dhëna të tjera si diakronia, etimologjia etj. Është paksa e vështirë të përcaktohet konkretisht zona e lindjes së frazeonjesisë, apo të flitet për të drejtën e autorësisë së saj. Këto shprehje janë bërë pjesë e makrosistemit, ndaj për të drejtën e autorësisë së tyre mund të pretendojnë njëkohësisht disa grupime banorësh, ose disa rajone a njësi administrative. Ose, mund të ndodhë që i njëjti rrëfim të variantizohet dhe rreth "pushtetit" për të drejtën autoriale - burimore të tij të pretendojnë disa zona apo disa qytete njëherësh. Një pjesë e këtyre njësive frazeologjike është e motivueshme edhe në gjendjen e sotme (në sinkroni) ndërsa pjesa tjetër është e pamotivueshme, por edhe kjo pjesë mund të motivohet historikisht (në diakroni).

### **Legjenda (gojëdhëna) - legjenda urbane**

Letërsia tradicionale e njeh legjendën ose gojëdhënën si tregim nga goja e popullit i cili iu kushtohet personave ose dukurive që kanë ndodhur, me kusht që këta persona apo dukuri të kenë lënë gjurmë të thella në jetën e një shoqërie. Në këto tregime, ndodhitë e gjithë personazheve apo aftësitë e personave prezantohen si fuqi mbinatyrore, mirëpo doemos lidhen me ndonjë të vërtetë. Në legjenda ose gojëdhëna, rëndësia apo efekti i tyre mundohen të prezantohen në tregim si fuqi mbinatyrore, dhe kjo tregon se si njerëzit e kanë ndjerë efektin e atij personi apo të asaj dukurie. Dallimi i legjendës apo gojëdhënës nga llojet e tregimeve të tjera është se legjendës nuk i dihet koha dhe vendi i zhvillimit të ngjarjes, ose njëri nga këto elemente. Pothuajse të gjithë popujt e botës kanë legjenda e tyre. Po ashtu, edhe shqiptarët kanë legjendat e tyre, disa në nivele më të ulëta e disa kanë arritur që të jenë edhe legjenda gjithëpopullore. Ndër legjendat gjithëpopullore te populli shqiptar, më të përmendurat janë rrëfimet mbi Gjergj Elez Alinë, Rozafatin, Konstandinin e Doruntinën etj. Ndryshe qëndron çështja te të ashtuquajturat legjenda urbane.

Rrëfenjat ose legjendat urbane ekzistojnë pothuajse në çdo kulturë dhe pretendohet të jenë të bazuara në ngjarje të vërteta, qoftë edhe të rastësishme. Disa nga këto histori janë ngjarje që nuk kanë dëshmi të duhura për t'i cilësuar si të vërteta. Në raste të tjera, ato janë larguar aq shumë në kohë prej ndodhisë nga e cila janë krijuar, sa mbamendja kolektive i ka tradhëtuar dhe nuk dëshmon më asgjë më shumë se sa vetëm shrehjen në formë togfjalëshi. Legjendat urbane fillimisht janë thjesht ngjarje të ndodhura në një zonë të caktuar. Rëndësia ose buja që mund të shkaktojnë, i përhap dhe gradualisht i kthen ato në histori të përfolura. Sa më shumë të jenë përfolur, aq më shumë i tejkalojnë kufinj të zonës ku janë krijuar së pari herë. Një legjendë urbane është një lloj rrëfenje mbi një ngjarje bashkëkohore, e cila ka të bëjë me histori të pazakonta, të besueshme apo të pabesueshme, të përçuar gojë më gojë; në kohërat moderne, shpesh të fryra nga mediat. Në të shumtën e rasteve, nuk dihet se si historia merr dhenë dhe brenda pak ditëve atë jo vetëm që e mëson i madh dhe i vogël, por rreth saj krijohet një interesim/ kuriozitet/ konfuzion i madh. Nuk ka vend as për sqarime, as për pyetje të detajuara, pasi askush nuk e di se kush kanë qenë të parët që kanë mësuar për lajmin në fjalë. Legjendat urbane sot janë kthyer në mite dhe folklor të së shkuarës, por te disa prej tyre ka kaq shumë elemente reale, sa të gjithë vrasim mendjen nëse janë të vërtetë apo jo. Sot e kësaj dite, ato i ndeshim në mënyrë të përhershme në shprehje frazeologjike, pra njësi të ngurtësuar, jo gjithmonë të kuptueshme dhe të qarta, por gjithsesi aq tepër të përdorura, sa që marrin edhe trajtën e së rëndomtës. Brenda tyre mbajnë edhe pjesën e shëndetshme të moralit, të ironizimit, të humorit, qoftë edhe humorit të zi a çkadoqoftë tjetër, pikërisht për shkak të asaj se si kanë arritur të bëhen të rëndësishme.

### **Struktura e së vërtetës**

Situatat qesharake ose dramatike, situatat e papritura dhe shtresimet mbi to, krijojnë një sistem që ka thurje komplekse. Në shumë raste ato janë një trik (truk), por megjithatë në raste po aq të shumta kanë një bazë fijesh të lidhur me realen. Njerëzit si shfaqje në jetë, vijnë e përsëriten nëpër shekuj, pra secili subjekt e ka vendin e vet të determinuar në mikrokozmosin e makrobotës sonë. Mizëria e përsëritjeve e bën ngjarjen dhe rrëfimin mbi të, fillimisht të shpeshtë, dhe mandej askush më nuk mendon mbi vërtetësinë. Shumë prej nesh kanë dëgjuar histori të çuditshme, të rralla, qesharake ose të frikshme, të cilat nuk dihet kur kanë lindur dhe pse vazhdojnë të mbeten në jetën e secilit. Rrëfenjat ose legjendat urbane janë histori ose fakte që përsëriten si të vërteta nga njerëzit që nuk e dinë origjinën e tyre. Ato përfshijnë ngjarje, subjekte që nguliten në mbamendjen kolektive kur vazhdimisht dhe për një kohë të gjatë përsëriten. Sidomos njerëzit e njohur, personalitetet e artit, politikës, nuk janë imunë ndaj ngjitjes së ndonjë tipari a emërtimi, i cili me kalimin e kohës i është bërë pjesë e identitetit. Rrëfenjave të tilla nuk i kanë shpëtuar personalitete të njohur për të cilët ndonjëherë edhe ndonjë ngjarje e vogël është kthyer në një rrëfim të përsëritur e të stërzmadhuar sikur në shprehjen “U bë qimja tra”.

Jo rrallë ndodh që rrëfenjat urbane të lidhen me personalitete të cilët gjatë gjithë jetës janë të rrethuar nga interesimi i shtuar i njerëzve. Nuk është e çuditshme se pikërisht pas vdekjes, për ta fliten ngjarje të stërholluara ose gjërat më të pakuptimta që mund të dëgjojë njeriu. Ndoshta kjo përlligj faktin se ata kanë qenë aq të mëdhenj, qoftë edhe në veprime të vogla, sa që rrëfenjat në gojë e njerëzve mund të jenë fanitje të përrallisura ose pandehma të ekzagjeruara ose të përafërta me realen. Ja një rast që ka të bëjë me shkrimtarin Ali Podrimja i cili në tërë Gjakovën është njohur me emrin Ali Italiani (Talioni). Që i ri, si atlet që ishte, ai dallohej nga të gjithë moshatarët e tjerë për shkathtësinë dhe guximin. Për këtë arsye, fillimisht shokët e ngushtë, e pas tyre edhe gjithë të tjerët, e thirrnin Ali Italiani sepse sipas tyre, ai kishte dukjen e një italiani zeshkan. Përveç kësaj, ishte ndër të parët që mori guximin për të kërcyer nga Ura e Fshenjtë me lartësi gati 20 metra mbi sipërfaqen e ujit. Si të mos mjaftonte lartësia e urës, ai shkonte dhe

hidhej edhe nga një majë më e lartë shkëmbi aty pranë, e cila si rrjedhojë u quajt “Maja e italianit”, për shkak të kërcyesit Ali Italiani. Aliu ishte i pari që u hodh nga kjo majë shkëmbore, më e lartë se vetë ura. Ai kërcente me stilin “dallëndyshe” duke fituar duartrokitjet e admirimin e gjithë të pranishmëve, ndërsa emri Ali Talioni e ndoqi gjithë jetën<sup>1</sup>. Ose rasti tjetër kur nofka “karrabishti” thuhet se iu vu tregtarit Dan nga Gjakova sepse ishte njeri i shkathët, tepër i aftë, dhe shfrytëzonte çdo mundësi a situatë për të qenë i suksesshëm. Pra, sipas këtij koncepti, ai ishte i lëvizshëm dhe i zhdërvjellët si një karrabisht. Për shkak të reputacionit të tij si njeri i punës dhe i gjeturisë, edhe rruga që shkonte për te shtëpia e tij, nga vetë bashkëqytetarët u thirr: Rruga e Dan Karrabishtit (ndodhet pas “Shtëpisë së mallrave”) dhe si e tillë njihet edhe sot e kësaj dite.<sup>2</sup> Jo rrallë herë, pjesë e rrëfimeve urbane është edhe intriga ose misteri. Përtej folklorit, në gjurmët drejt së vërtetës na prijnë disa ngjarje. Dhe në mënyrë të tillë, zënë fill e marrin krahë legendat folklorike, shpesh duke mjegulluar të vërtetat. Kështu, duke besuar në legendat urbane, pronari i një pjesë toke në fshatin Stropckë të Dardhës në Pogradec, ka nisur kërkimin për të gjetur florinj. Pas ditëve të para të gjermimit me lopata, kryefamiljarit fillimisht iu bashkua e tërë familja, dhe mandej këmbëngulja e tyre bëri që gjermimet të vazhdojnë me eskavator. Gjermimet vazhduan me vite, por më kot. Kotësisë së këtij veprimi të pavlerë iu vesh qesëndia dhe ironia e bashkëfshatarëve. Si rezultat, pas disa kohë gjermimesh të kota dhe pa asnjë rezultat, lindi shprehja idiomatike: “Gërmo e gërmo, se qenin e ngordhur do të gjesh!”

### **Gdhendja në frazeonjësi**

Nga pikëpamja gjuhësore, karakteristikë e idiomave është se ato kanë shkallën më të lartë të ngurosjes ndaj elementet në to kanë humbur pavarësinë kuptimore. Ato kanë humbur kuptimin fillestar dhe për këtë arsye përdoren vetëm në rrafshin e dytë kuptimor, atë të figurshëm. Gjithashtu ato nuk mund të zëvendësohen nga sinonimet dhe as nuk pranojnë fjalë të tjera mes tyre. Të tilla janë edhe njësitë frazeologjike që rrjedhin nga ngjarje a rrëfime historike të panjohura sot, ose të njohura deri diku, apo nga të ashtuquajturat legjenda urbane, ngjarje që kanë ndodhur dikur dhe me kalimin e kohës janë ngulitur në mbamendjen kolektive. Si të tilla ato vazhdojnë të jetojnë për shumë e shumë kohë më pas, por tashmë vetëm si shprehje e ngurosur.

Për shembull: SHKOJKE SI MUÇA PAS DAIS, NUK NIN MULA PËR SHULA, U MÉT SI MAKSUTI N’RAMAZAN, JE BO ME T’ÇU TE MAHMUTI, A PO FOL HAJDARI A PO PLEET MAGARI?, SHKO ANKOHU TE EFA, E KOHËS S’ALI BUNGIT, SI N’MALL T’DËRZHAVËS, SI N’KOH’ T’GJERMONIT etj.

Këto janë disa nga frazeologjizmat në të cilat vërehet prania e emrit të përveçëm, për të cilin ka lindur dikur rrëfimi. Zanafilla e rrëfimit sot nuk mbahet mend, por rëndësi ka që shprehja ka mbetur, e bashkë me të edhe emri i (krye) personazhit ose epokës (kohës) për të cilën bëhet fjalë. Gjuhëtarët vërejnë pamundësinë e idiomave për t’u përkthyer në gjuhë të tjera pasi për këtë pengon veçoria e tyre kryesore: pamundësia për t’u zbërthyer dhe për të nxjerrë elementet nga kuptimi i së tërës. Në përgjithësi, idiomat janë në numër të vogël dhe i përkasin një shtrese më të hershme. Por ato janë njësi të motivueshme edhe në përdorimin e sotëm.<sup>3</sup> Karakteristikë kryesore e tyre është pamundësia për t’u zbërthyer kuptimisht, pamundësia për të nxjerrë kuptimin e së tërës nga gjymtyrët. Idioma frazeologjike paraqitet si njësi kuptimore e njëvlershme me fjalën, e zhveshur nga forma e brendshme dhe me një shkrirje të brendshme të gjymtyrëve. Idiomat nuk motivohen sepse në gjendjen e sotme të gjuhës, lidhja e brendshme nuk duket

<sup>1</sup> M. Arllati, M. Rugova, “Patronimet në Gjakovë, mbiemrat, emrat familjarë”, f. 107.

<sup>2</sup> M. Arllati, M. Rugova, “Patronimet në Gjakovë, mbiemrat, emrat familjarë”, f. 101.

<sup>3</sup> M. Arllati, “Vështrim në frazeologjinë e të folmes së Gjakovës”, f. 47.

më. Për shembull, ne sot e kemi tepër të vështirë në mos të pamundur për të vërtetuar se në ç'rrugë është arritur të bëhet lidhja e fjalëve te njësia BËJ PALLËN E SEFAS' e cila ka kuptimin "bëj qejf të madh". Për një numër relativisht të vogël të frazeologjizmave që vijnë nga legjendat urbane, mbamendja kolektive mund të sjellë ndër mend, nën mjegullën e kohëve të largëta (minimumi disa dekadëshe), ngjarjen ose rrëfimin nga ka mbetur ajo shprehje. Për shembull, banorët e fshatit Dardhë të Korçës janë përmendur se kanë bërë prerjen dhe tregtinë e lëndës së drurit nga Greqia e Veriut drejt Anadollit. Prej këtij zanati të tyre ka mbetur edhe shprehja: "Ta pret me sopatën e dardharit". Pra shprehja merr përsipër të tregojë se dardharët janë prerës dhe punues të dëshmuar të drurit.

Në Gjakovë përdoret shprehja "S'ka mo tula t'magarit", e cila nënkupton se një e mirë e mëhershme ka shkuar dhe nuk mund të përsëritet më. Sipas gjakovarëve të vjetër, shprehja ka zënë fill në një ngjarje të vërtetë, kur një ditë prej ditësh njërit prej qytetarëve i kish ngordhur magari (gomari). Duke i ardhur keq për humbjen e kafshës të cilin ai e kish përdorur për punë të ndryshme, pronarit i dhimbset ta hedhë e ta gproposë, ndaj pa një pa dy, e ther dhe mishin e tij e përdor për të përgatitur qebapët që do t'i shiste të nesërmen në qebaptore. Duke qenë se për këtë mish ai nuk harxhoi asnjë të hollë, përgatiti qofte dhe qebapë më të mëdhenj se zakonisht. Të nesërmen, jo vetëm që askush nuk vuri re se mishi ishte më ndryshe, por përkundrazi, qebapët u shitën me të shpejtë, meqë përmasa e tyre ishte më e madhe se zakonisht. Çudia ndodhi të pasnesërmen kur myshterinjtë erdhën të blejnë samuna me qofte dhe panë se qebapët ishin bërë sërish më të vegjël, ashtu siç kishin qenë gjithmonë. Meqë një ditë më parë madhësia kishte qenë më e rritur, ata të befasuara e pyesin pronarin e qebaptores: "Çka ndodhi? Pse u zvogëlun këta qebapa kështu sot?" Dhe ai iu përgjigj: "Eeee, s'ka mo tula t'magarit, pse përditë dashtët ju?" Dhe askujt prej klientëve nuk i shkante ndër mend se ditën e djeshme ishin ushqyer me qofte dhe qebapë të përgatitur me mishin e gomarit të ngordhur. Sot e kësaj dite, shprehja "S'ka mo tula t'magarit" tregon se jo çdo ditë mund të përjetohet një "e mirë" e cila ka ndodhur një herë, qoftë edhe rastësisht apo gabimisht.

Në pasurinë e frazeologjisë shqipe, përdoren gjerësisht frazeologjizma të cilat mendohet se janë ndërtuar mbi një rrëfim të gjallë. Elementin e vërtetësisë mund ta kemi disi më të garantuar në rastin kur shprehja përmban në strukturën e saj një emër të përveçëm ose një emërtim konkret (për periudhën, lokalitetin, rangun e personit etj). Emri i përveçëm ose konkretësia e bëjnë atë të jetë më i lidhur me vërtetësinë. Përdorimi i tyre mund të jetë lokal, i përhapur në treva të caktuara ose mund të ketë shtrirje në tërësi tek të gjithë shqipfolësit. Ja disa prej tyre:

ME LEJE T'BAJRAM CURRIT/KUR T'PIQEN FIQT' E MALIQIT/VAJTI NAMI TE MOLLA KUQE /DHENTË E DHITË T'ZENËS E NAMI I KAPLLAN QERES/ME INATI NUK RRXOHET GJERAVICA/PASHA TEQEN E MADHE/BAJRAMI I VOGËL S'FALET PARA T'MADHIT/ALI HOXHA, HOXHË ALIA/JE BO SI M'I IK HOXHËS PREJ TABUTI TU E LYP SI QORRI COPËN/QEFI MA I MADH SE STAMBOLLI/HYP KTU E KQYR STAMOLLIN/HAMAMI HYRES/ZOJA E PARISIT/E BIJA E RROK FELERIT/DASHNORËT E VENEDIKUT/RAMADANI I GRAVE/DY KAMBERË NË NJI DERË/S'KA ME T'LA AS DRI, AS ERENK/U KALL ERENKU/E KISH SHPIN' N'ZEMËR T'GJAKOVËS/MOS U BOFSH ME T'KAJT RAHOVECI/TAMAM SI MIJA XHARRËS/JE BO SI NURA E CILINËS/JE BO MOS ME T'PRANU AS SPITALI SHKUPIT/I KOHËS ALI BUNGUT/SI N'KOH' T'BABA QEMOS/ARRNAUT HEJ ARRNAUT, N'VEN' T'BUKËS BLEN BARUT/SHQIPNIA E VOGËL, SHQIPTARËT SHPIRTMDHENJ/S'E LUN AS TOPI I ALI PASHËS/KADAL' BEG SE KA HENDEK/KA THON' SHABAN PAJA, DALLAP - DALLAP DYNJAJA/SHKA I KA THON' DEMA UKËS, NJI CIGARE SHKON MAS BUKËS I KA THON

DEMA KADRRIS', S'PO IA DIN RENIN BURRNIS'/AS DORËSHTRËNGUAR SI SELMANI, AS DORËLËSHUAR SI SELIM SHABANI/FOLI SI E ËMA E ZEPOS N'MAJ' T'THANËS/E HUMBI SI XHAFERRI SIMITEN/DO EDHE MUÇOJA KAFE, SE KISHTE PI EDHE DJE/FARA E VENDIT, MUSHKA E GOLEMIT/MA MIR' ME THAN' QE LEKA, SE QE VORRI I LEK'S/I DIN META PUNËT E VETA/META ME DY KULETA/ALI UKA ME DY KRRUTA/PUNON DANA, HAN RAMA/SI HASA ME HYSËN/QYSH N'KOH' T'NAPËRDAKUT/PO PËRLAHEN SI SHKIJET/SE KE TI JOVANKA E TITOS/VEÇ TU LAZDRU, MA ZI SE NAZA KAKIQKËS/JE BO SI ALI RUDI/I MENÇËM SI SADIK DIGITRONI/IA QËLLOVE SI BEN SAHATI/PUNON SI SAHATI ZVICRRËS etj.

## **PËRFUNDIME**

Sikurse shihet, shumica prej tyre mbajnë në strukturë një emër të përveçëm për të cilin mendohet se ka lindur rrëfimi, pavarësisht se sot nuk ka rëndësi nëse mbahet mend ose jo se cili ka qenë konkretisht ai person. Si të tilla, rrëfenjat urbane vazhdojnë të jetojnë sot në gojën e popullit, si dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre mbetet e gdhendur në njësi frazeologjike, brenda të cilave e kanë të garantuar jetëgjatësinë.

## **STUDIME MBËSHTEËSE DHE REFERENCA**

1. Migena Arllati, *“Vështrim në frazeologjinë e të folmes së Gjakovës”*, Shoqata e Intelektualëve “Jakova”, Gjakovë 2014.  
Migena Arllati, Muhamet Rugova, *“Patronimet në Gjakovë, mbiemrat, emrat familjarë”*, Shoqata e Intelektualëve “Jakova”, Gjakovë 2015.